

SHKRIME ETRUSKE QË FLASIN SHQIP

Studiuese, Ana **HIDA**
Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Shenjat e pamohueshme që dalëngadalë po zbulohen tregojnë që populli ynë është ndër popujt më të vjetër të Europës jo vetëm që i dha kulturën e agrikulturën por gjuha shqipe është baza e shumë gjuhëve europiane dhe më larg. Përse ky shkrim? Do përpiqem të sjell pesë momente dhe duke i ndërlidhur ndërmjet tyre do të shohim çfarë i bashkon këto shkrime? Përse *Lapis Nigeris* është mbajtur deri tani si shkrimi i parë në Latinisht, por që nuk ka asnjë fjalë latine. Çfarë e lidh Gurin e Xhuxhës me shkrimet etruske? Guri mbi kishën e Zojës së Shkodrës në Itali çfarë lidhje ka me shkrimet e vjetra? Të gjithë këtyre pyetjeve do kërkojmë t’iu japim përgjigje.

Fjalë kyçe: Etrusk, Ed, Od, Guri i Xhuxhës, Venere, Afrodita, gjuha shqipe, Lapis Niger, Vazo di Duono, hoje, nipa, daja, falja, Zoja e Shkodrës, Pellazg, Ilir, dhimbje.

Na kanë quajtur popull të legjendave, dhe përrallave që nuk lamë asgjë të shkruar, që shkruam në gjuhën e pushtuesve romakë, që shkruam në greqisht, që shkruam në turqisht. Na thonë që kemi një të trasmetuar gojarisht. Kjo është dhe e vërtetë se ne trasmetuam në menyre orale gjuhën Pellazge, Ilire-Shqipe, po jo se deshëm ne por, dikush na detyronte, çdo herë që na zaptonte të bëheshim pjesë e tyre, të na zhdukte me mënyra nga më të ndryshmet. Kështu mbase kujtuan por, u gabuan sepse Guri i Xhuxhës dhe të tjerë gurë anembanë trojeve tona, na thonë se ne kemi të drejtë kur themi se jemi popull më i vjetër dhe që mbijetuam me gjuhën e folur por dhe të shkruar. Të huajt nuk ishin të interesuar (e nuk janë të interesuar), që ne të flisnim e të flasim për historinë tonë, të shkruanim shqip sepse, do mbaronin historitë e tyre të cilat u bazuan shpesh herë mbi Pellazgët- ilirët, ose mbi barbarët siç na quanin sepse flisnin e shkruanim një gjuhë të ndryshme nga ato, që gjuhën e vjetër Etruske – Ilire-Shqipe e bënë të tyren, zhdukën fise, dëshmitarë por nuk arritën të zhduknin nëntokën, vendin ku fshihen bibliotekat e vjetra tonat, jo vetëm thesare, minerale por, dhe shumë fjalë e shkronja shqip, sidomos në mesdhe.

Neve u ndamë nga bota, por kultura dhe pasuria jonë trashëgimore filloj të flasë, të kalonte çdo cak, çdo rregull të vendosur nga brenda e nga jashtë, të dalin minatorë, jo të mineraleve por të të pathënave, të legjendave, të toponimeve, të gurëve. Shpesh herë, është e vështirë të ndash nga vjen një histori apo një tjetër se për vete pozicionin gjeografik të Ballkanit, dhe për vetë popujt që jetuan e që jetojnë shumë afër njëri-tjetrit, gjërat tona kanë kaluar kufijtë e janë përvetësuar, tjetërsuar, zhdukur me forcë ose bëjnë, sikur harrohen ose nuk u shkohet gjërave gjerë në fund sepse ju dalin shqiptare, e kështu fallsifikojnë dhe më e keqja se të tjerë u besojnë këtyre fallsifikimeve, pra u besojnë gënjeshtreve të veta. Prandaj, Guri i Gjugjës (Xhuxhës) është si një shuplakë që vjen nga historia, për të treguar se ne kishim gjuhë, kishim alfabet, e se nuk gjenden pllaka ose tavoleta vetëm në Francë, Itali e Spanjë, Brazil por dhe në Mirditën e Vjetër, në Xhuxhën e minierave dhe përshkrimi i bërë më sipër i Gurit shpjegon më së miri jo vetëm që kishim alfabet, por kishim dhe një histori tonën. Në librin "L'Etrusco lingua viva" (Etruska gjuhe e gjalle)" 1989, dhe "Pellazgët Ilirët , Shqiptarët" 1984 dhe në Librin" Patrimonio linguistico genetico". "Studiuesja shqiptare Nermin Vlora Fallaski u mor me shkrimet që nuk përktheheshin as në italisht dhe as në greqisht nga Etruskja e Pellazgjikja (Stelle di Lemnos) duke përdorur gjuhën moderne shqiptare, ajo arriti të përkthente edhe poezi të këtyre njerëzve antikë, që akoma e kësaj dite përpiqen t’u mohojnë prejardhjen, kjo dëshmon se Shqiptarët janë pasardhës të Ilirëve ashtu si dhe Ilirët janë pasardhës të Pellazgëve dhe një prej stirpeve më të vjetra të Europës "Ja disa prej përkthime të zonjës Vlora Falaski . Ajo e lidh Toskanen e sotme ish atdheun e Etruskëve me Toskerinë tonë, pra një pjese të jugut të Shqipërisë. Ajo thotë që fjala Toskë është fjala Tokë. Në Toskane gjejmë qytetin e vjetër të

Cortona që thuhet se u formua nga Pellazgët. Në shqip Cortona-Korrjet Tona. Nga muzeu arkeologjik i Cortones Nermin Vlora përktheu shkrimin etrusk në gjuhën shqipe. "Anija është për ne, forcë dhe liri". Fondet historike tregojnë që grekët morën prej pellazgëve jo vetëm punimin e metaleve dhe ndërtimin e mureve, por dhe mënyrën e të shkruarit dhe bënë të tyre dhe Hyjnitë Demitra, Dheu i mitrës, dmth Perëndesha e Nënës Tokë, Afrodite, Afër dita. Pellazgët - Shpellazgët popull i detit u quajt prej romakëve sepse ishin lundërtar të Zotë dhe po këta e quajtën Ilirik dhe atdheu i tyre Iliri, Vendi i popullit të lirë" që ishte nga Mesdheu deri në Danub, në Lazio akoma sot egzistojnë mali Lir, lumi Lir, Burimi i Lirit.



SHKRONJA TË PËRDORURA TEK GURI I XHUXHËS

J = P	-	ETRUSKO
o = o = f	-	ETRUSKO
Y = M	-	MARSIGLIANA ALBEGNA
I = I	-	TE GJITHË ALFABETËT E VJETËR
L = P	-	PICENO
M = N	-	ETRUSKO KLASIK
L = P	-	ARKEIK
o = o	-	TE GJITHË ALFABETËT E VJETËR
⊕ = z	-	MARSIGLIANA ALBEGNA - (FORMA TË GJATË)
+ = T	-	MARSIGLIANA ALBEGNA - (E MË VONË)
B = H	-	TE GJITHË ALFABETËT
f = I	-	ETRUSKO ARKEIKO
V = N	-	TE GJITHË ALFABETËT
⊕ = SH	-	" "
⊕ = TH	-	" "
Y = U	-	MARSIGLIANA ALBEGNA ORIGINALE
> = L	-	ETRUSKO ARKEIKO

Duke kaluar tek Guri i Xhuxhës në pamje të parë duken shumë nga shkronjat që përdori edhe Nermin Vlora në perkthimin po themi nga gjuha etruske – shqipe në atë italiane. Është një ansambël shkronjash të përdorura në Gurin e Xhuxhës që i përkasin alfabetëve; Pellazg, Etrusk, Ilir, Mesapik, Osc. Kjo na bën të mendojmë që në këto treva të Mirdites që në atë kohë kishim një alfabet dhe një gjuhë të shkruar, ku flitej gjuha e vjetër, e nga kjo gjuhë dolën shumë dialekte, do të thotë se shkronjat e alfabetit të shkruara në gurin e vjetër janë nëna e alfabetëve të këtyre gjuhëve të përmendura më sipër sepse gjuha e Gurit ka pjesë tek të gjitha këto alfabete. U tha më sipër se gëdhendjet e bëra tek guri, janë shkronja të vjetra prandaj leximi i tyre duhet të fillojë nga e djathta në të majtë, pamjet e shkronjave të kujtojnë shumë gjuhën Etruske dhe alfabetet e saj, këto na kujtojnë alfabetin Etrusk. Ndahen në rrokje dhe në shumë raste shkronjat mbështeten tek njëra-tjetra kur është e mundshme lidhja mes dy ose më shumë shkronjash të së njëjtës fjalë, bëhet atëherë, kur vizat vertikale gjenden në vazhdimësi ndërmjet tyre. Dhe kjo lidhje bën edhe më të mundur që shkronja e parë të jetë pjesë formuese edhe e shkronjës tjetër duke formuar dhe rrokjet. Për të zgjidhur rebusin një ndihmë të madhe dhanë keto alfabete antike që i cituam më sipër por, nuk dhame burimin e informacionit sepse, në faqet e internetit mjafton të klikosh Alfabete të Vjetra dhe dalin një sërë dhe shumë prej tyre i përkasin gjuhës Etruske sidomos në vendet ku kanë jetuar Pellazgo illirët.



Vijmë tek fjala jonë, në dukje kemi një drejtkëndësh të ndarë në pesë pjesë, tre pjesët e para janë të lidhura ndërmjet tyre, ndërsa dy pjesët e tjera janë ndryshe. Fillojmë të lexojmë, në gjuhën e vjetër drejtkëndëshi i ndarë në dy pjesë është H pra H shihet shumë mirë, por siç thamë, lidhen ndërmjet tyre dhe e para është pjesë formuese e shkronjës së dytë, pra këmba e dytë e H-së është I, sepse I formohet nga këmba e dytë e H me vizën lidhëse të H-së nga ana e djathtë, pjesa e mesit të H nuk shkon gjer në fund, nuk lidh plotësisht këmbën tjetër të H, kështu këmba e dytë e H dhe viza në mes nga ana e djathtë formojnë shkronjën I, pra shkronja e dytë është I. Shkronja e tretë është këmba e dytë e H e cila në këtë rast nuk lidhet nga e djathta po lidhet me një vizë diagonale nga ana e majtë e saj, kjo vizë diagonale lidh vizën vertikale me vizën tjetër duke formuar shkronjën N drejtkëndëshi që formohet përsëritet, është i njëjtë pra me drejtkëndëshin e fillimit dhe ai po ashtu i ndarë në dy pjesë janë dy shkronja I dhe H pra, shkronja e katërt është përsëri I dhe e pesta është H i lidhim së bashku dhe del fjala HINIH. Kalojmë tek fjalët e dyta që janë të lidhura bashkë me fjalën Hinih, po të shohim dy kuadratët e sipërm i pari kuadrat në alfabetet e vjetra na përfaqëson shkronjën O, kuadrati i dytë me kryq në mes në gjuhët e lashta e nga e djathta është S ose Sh. Kuadrati i tretë është nga poshtë që në dukje duket si shkronja Y është shkronja U dhe kuadrati i fundit nga e majta është shkronja e fundit L atëherë fjala e dytë është OSH dhe fjala e tretë UL.

Lexojmë të tre fjalët siç lexohen sot: HINIH OSH UL. Çdo të thotë kjo fjalë HiniH në fjalorin Etrusk - Italisht, do të thotë Anima, ne nuk kemi një fjalor Etrusk-Shqip, prandaj gjejmë Hiniial = me Anima, në shqip dhe në përdorimin e gjerë të gjuhës shqipe nuk egziston fjala Anima përkthehet vetëm Shpirt. Hinih –Hyj –Shpirt/Hin-Anima-Shpirt/Hin-Hyn-Hyj-Zot/Hyj -folje që tregon veprim hyrës përveçse perendi/Në gjuhën shqipe fjala Hyn=Hyj-Zot-Yll- Hyj = Shpirt , pra të vjetrit fjalën/Hyj –HYN e kanë përdorur si diçka të shenjtë jo vetem Zot por edhe një frymë e shenjtë që Hyn në trup dmth, Shpirt. Meqënëse në gjuhën tonë nuk egziston fjala Anima, Anima që do të thotë shpirt atëherë mundet t'a lexojmë:

Shpirti osh ul = Shpirti është ul-/Shpirti është Ulur

Nëse me shpirtin ne nënkuptojmë diçka të mbinatyrshme jo materiale që vjen nga lartë që Hyn dhe që i bashkohet trupit mundet dhe të themi që bëhet Shpirt. Hyj është ul që mund t'a marrim edhe: Hyji është Ul=ulur, Hyji është ul= SHPIRTRAT JANE ULUR tregon një situatë që përpara ishte shumë e keqe , që mund të ketë pasur vrasje , gjak, masakra por që në atë kuvend paqejt u përpoqen ti zgjidhnin dhe i dhanë fund asaj situatë.

Guri i muzeut të Firences



Ky gur që shihni sipër është gjetur në një varr etrusk dhe sot gjendet në muzeun arkeologjik të Firences.

Ne si shqiptarë pasardhës të Pellazgëve - etruskë këtë pllakë e deshifrojmë pa më të voglin sforcim. Duke filluar të lexojmë nga e djathta në të majtë, siç lexonin të parët tanë dhe kemi këto shkronja: N I P A D O I A H. NIPA E DAJAH, ose Nipa e Daja. Çfarë kanë dashur të thonë të parët që flisnin të njëjtën gjuhë si neve në këtë pllakë. Sigurisht shprehja që ne atë varr gjendeshin të varrosur nipat dhe dajat bashkë: Ishin vranë në ndonjë luftë? vuanin nga e njëjta sëmundje, kishin vdekur nga ndonjë tërmet? Të kishte pasur ndonjë grindje mes tyre as mund t' a llogarisim sepse nuk do ishin varrosur bashkë. Sigurisht një ngjarje e rëndë ka ndodhur aq sa kujtohet pas mijëra vjetësh nga vizitorët e këtyre muzeve pa e ditur se çthuhet mbi këtë pllakë.

Shumë mendojnë se jemi duke endërruar me sy hapur. Mario Guarnaci në Librin e tij: Origjinë italice apo janë kujtime dhe histori etruske. Thotë Pellzgët ishin Etruske thotë që Etruskët ishin edhe Liburn dhe Liburnët ishin Ilir pra i bie që etruskët të ishin dhe ilir.

Vazoja e Duenos



Transkriptimi arkaik i të cilit mund të jetë: iovesat deivos qoi med mitat nei ted endo cosmis virco sied asted noisi opetoi tesiai pacari vois duenos med feced en manom einom duenoi ne med malos tatod Perkthimi ne latinishten klasike iurat deos qui me mitat ni in te comis virgo sit. at te nisi [OPETOITESIAI] pacari vis. Bonus me fecit in [MANOM EINOM] bono. ne me malus tollito. Në italisht përkthimi me i akredituar është: *Chi mi invia prega gli dèi che nessuna vergine ti sia compagna. se non vuoi essere soddisfatto per opera di Toteria. Un buono mi fece, e per causa mia nelle mani di*

quel buono non torni il male. (Iscrizioni di Dueno – Wikipedia) Përkthimi shqip (Kush më dërgon, u lutet perëndive që asnjë e virgjër të mos jetë shoqëruesja jote. Nëse nuk doni të kënaqeni nga Toteria. Ai më bëri një të mirë dhe për hirin tim e keqja nuk kthehet në duart e asaj të mire.)

Vaso di Dueno' u gjet në kodrën Quirinale dhe shkrimet që e zbukurojnë atë janë konsideruar gjithmonë një nga dokumentat më të vjetra të shkruara në latinishten arkaike. Por, sipas një studiuesi të Osit, frazat e gdhendura rreth vitit 600 para Krishtit gjenden në gjuhën Sarde. "Para meje, ky dokument u analizua dhe u studiuua - shpjegoi Bartolomeo Porcheddu për Ansa. Por gjithnjë duke supozuar se teksti ishte në latinisht. Fjalë latine kërkoheshin në ato fraza, por nuk gjenden aty. E përktheva në Sardenjë dhe rezultati ishte i pabesueshëm: është krejtësisht ndryshe nga përkthimi i mëparshëm. Dhe nuk ka më probleme që karakterizuan studimet në dokument përkthimi tani i përgjigjet përsosmërisht tekstit". Studiuesi sardinian është një mbështetës i teorisë revolucionare, sipas së cilës latinishtja rrjedh nga gjuha antike që flitet në ishull. "Gjuha Sarde ka qenë gjuhë ndërkombëtare e Mesdheut për vite me radhë - shpjegon ai. Në vitin 600 para Krishtit ne jemi në një fazë të rënies së civilizimit Nuragic, por ndikimi i gjuhës është ende shumë i fortë. Latinishtja që do të përdoret më pas do të ndërtohet në bazë të gjuhës Sarde, gjuha në të cilën do të zbatohen edhe rastet greke. Askush nuk e ka vërejtur atë për dy mijë vjet, sepse askush nuk është përqendruar në studimin krahasues midis latinishtes dhe gjuhës". Tri vazoja e Duenos u gjet nga Heinrich Dressel në 1880, në një depozitë në Quirinale në Romë dhe u mbajt në Muzeun Shtetëror në Gjermani. Sardenja e Berlinit në Universitetin e Cagliari, ka botuar një libër me titull "Vazoja e Dueno" ku ai shpjegon teorinë e tij me detaje teknike nga pikëpamja gjuhësore, siç është mos-pajtimi i rasteve në analizën e tekstit: "është prodhuar më parë se Romakët të cilët e shndërruan gjuhën e tyre Sarde-Latine në 'Latinishten e zakonshme' duke futur 'rastet' Greke në morfemat nominale", shpjegon ai për Ansa. Me rileximin e tekstit të bërë nga gjuhëtari sardinian, ndryshon kuptimi i tekstit, i cili është analizuar gjithmonë me shumë vështirësi, sepse është shkruar rreth tre enëve që përbëjnë vazon, pa hapësira dhe pikësime. Për Porcheddun struktura e fjalive është ajo e Sardenjës aktuale, e cila del në emra vetëm me gjininë dhe numrin, pa 'rastet' me origjinë greke": kjo frazë e pranishme në mbishkrim do të kishte kuptim vetëm nëse përkthehej si ajo mënyra e brohoritjeve itineze sardeze (çfarë doni).

Në shqip Iove sat dei vosqoi med mi tat neit Ed e ndo cos misvir co zi Ed Ast ed noi si opet oi te si ai pac a ri vo is Due nos med fe ce den ma nom ei nom due noi ne med maros tat od Iove -Zoti sat-Sot dei-Perendite iv- ju osqoi- oskoi med-medet mi-ma tat –jot neit-qendrove ed- Ed e – e ndo cos – ndo kush misvir- mizuir co-ke si – zi Ed Ast – asht ed-Ed noi-nai si –zi opet-perseri oi –ai te-the si –zi ai-ai pa- pashikoj a –eshte ri – i ri jo-jo is-ish Due-dy nos-nesh med – medet fe-the ce-qe den-dhen ma -a nom-nam ei nom-nam due –dy noi-nesh ne-na med –medet maros –maraku tat -jot Od

Latinisht	Shqip	Italisht	Si lexohet shqip
Iove	Giove	Dio	Zot
Sat	Sot	Oggi	Sot
Dei		Dei	Perendi
Iv	ju	voi	Ju
Osqoi	Oskoi	Osc	Oskoj
Med	Medet	Che dolore	Sa dhimbje
Mi		Per me	Per mua
Tat	Jot, Yt	Tuo, te	Ty
Neit	Nejte	Sii forte	Qendro
Ed	Eduard	Eduardo	Ed
Ndo cos	Ndokush	qualcuno	dikush

Mizuir	Mizor	Terribile	Mizor
Ko	Ke	Era	Qe
si	zi	Nero, cattivo, luto	I Zi
Ed	Eduardo	Eduardo	Ed
Ast	Asht	E'. C'era	Eshtë
Ed	Eduardo	Eduardo	Ed
Noi	Nai	Qualcuno	Ndonjë
Opet	Apet	Di nuovo	Përsëri
Oi	Ai	Lui	Ai
Pa	Pa	Ti ha visto	Të ka parë
A	Asht	E'	Eshtë
Ri	I ri	Giovane	I Ri
Jo	Jo	No	JO
Dye		Due	Dy
Nos	Nesh	Da noi	Prej nesh
Med	Medet	Che guaio	Sa keq (çfarë halli)
Fe	The	Hai detto	The
Ce	Qe	Eco	Ja
Den	Dhen	Dato	Dhen
Ma	Ma a	Ma e	Po është
Nom	Nam	Tragedia , tristezza, dolore	Dhimbje
Ei	Ei	Si	Po
Nom	Nam	Tragedia , tristezza, dolore.	Dhimbje
Due		Due	Dy
Noi	Nesh	Da Noi	Prej nesh
Ne	Na	Noi	Neve
Med	Medet	Dolore	Dhimbje
Maros	Maraz	Profonde tristezza	Hidhërim i thellë , brengë
Tat	Jot, yt, ty	Tuo	Per ty
Ed	Eduard	Eduardo	Ed

E përkthyer nga Italianët. Kush më dërgon, i lutet perëndive që asnjë virgjëreshë të mos jetë shoqëruese. Nëse nuk doni të jeni të kënaqur nga Toteria. Ai më bëri një të mirë dhe për hirin tim e keqja nuk do të kthehet në duart e asaj të mire.

SOT O ZOT PERËNDI DHE JU OSKOJ/PËR MUA QËNDRO I FORTË ED/DIKUSH QE I ZI DHE MIZOR DHE ËSHTË/AI TË KA PARË NUK ËSHTË I RI/SA KEQ DY PREJ NESH JA DHANË/DHIMBJE PO ËSHTË DHIMBJE/DY PREJ NESH DHIMBJE/HIDHËRIM PËR TY ED

Fjala që bie më shume në sy ishte Oskoj në vazon e shkruar është Osk. Kush ishin Oskët?

1. Osci- Termi "Osci" vjen nga ops-ci, përshtatje e mundshme në gjuhën Oscan të termit "Opici", i cili përcaktoi njerëzit Latin-Faliscan (ose protolatinë) tashmë të vendosur në hinterlandin e Campania në kohën e depërtimit të fiseve të para Samnite. Përshtatja u lehtësua nga prania, në Oscan, e një teme nominale ops- (krh. Latin ops, "burim"), i cili bëri të mundur interpretimin e etnonimit si "njerëz të punëtorëve", ose ndoshta edhe "njerëz të adhuruesve të perëndeshë Ops "[1]. ^ Giacomo Devoto, *Gli antichi Italici*, p. 112.

Osci, me prejardhje Samnite, u vendosën në vendin e tyre historik - Opicia - në shekujt e parë të mijëvjeçarit të parë para Krishtit, mbase edhe më herët, dhe u mbivendosën mbi një popullsi ekzistuese Latine-Faliscane, Opici. Bërthama qendrore e vendbanimit të tyre ishte prapavija e Gjirit të Napolit, por provat e Oskanit, veçanërisht gjuhësore, dëshmojnë në një zonë shumë më të gjerë, që shtrihet drejt lindjes dhe jugut, deri në Kalabrinë e sotme veriore. Fiset Oscan banonin në ishullin Vivara që nga epoka e bronzit; kur kolonistët grekë erdhën në brigjet e Cumës për të gjetur qytetin, ata gjetën një vendbanim Oscan në kodrën e akropolit. Pompei dhe Herculaneum u themeluan gjithashtu nga njerëz Oscan, në shekullin e gjashtë para Krishtit, Alife dhe Atella.


3. Rajonet bregdetare të banuara nga Osci u pushtuan nga Grekët e Cuma (dhe më pas të Napolis) tashmë në VII. Në shekullin V para Krishtit Osci u nënshtrua nga Samnitët, një tjetër popull Osko-Umbrian shumë i ngjashëm me ta dhe së fundmi nga Romakët, të cilët pushtuan zonën gjatë shekullit të katërt para Krishtit, pas Luftërave Samnite.

4. Burimet antike, veçanërisht romake, kujtojnë emrin dhe ngjarjet e fiseve të ndryshme Oscan, në kuptimin më të gjerë të termit (kryesisht gjuhësor). Aurunci, u vendosën në zonën e pesë qyteteve të Aurunca Pentapolis, në të ashtuquajturin "Latium adiectum" dhe në rrethinat e afërta. Ata iu nënshtruan Romës në fund të Luftës së Dytë Samnite, në 313 para Krishtit, dhe Pentapolis u shkatërrua. Shumë të ngjashme me Aurunci ishin Ausoni të përmendura nga burimet Greke dhe Latine: është e mundur që etnonimi të ishte një formë alternative e Aurunci, ose që ai tregonte edhe vetë Osci në tërësinë e tyre. Më në jug ishin Lucanët, në një zonë që korrespondon afërsisht me rajonin që mban emrin e tyre dhe që shtrihej deri në Detin Jon.

5. Nuk dihet se sa Osci humbën individualitetin e tyre etnik-gjuhësor për t'u romanizuar plotësisht. Midis mbishkrimeve të gjetura në gërmimet arkeologjike të Pompeit, mbishkrime u gjetën në gjuhën e tyre, e cila është akoma e gjallë në shekullin e parë para Krishtit.

Francisco Villar, *Indo-Evropianët dhe origjina e Evropës*, f. 483

Lapis Nigeris



Mbishkrimi daton që nga viti 575-555 para Krishtit. Mbishkrimi i Cipusit është i gjymtuar dhe ka formën e një piramide është në një alfabet latin arkaik, me karaktere alfabetike të prejardhjes greko-etruske, (kështu thuhet gjermë tani). Shkruhet herë nga njëra anë herë nga tjetra (si alternativë, nga e majta në të djathtë dhe nga e djathta në të majtë, si lëvizin qetë kur lërojnë fushën (UKIPEDIA). Deri në demonstrimin e vërtetësisë së fibulës prenestine, ky dukej se ishte mbishkrimi më i vjetër latin i gjetur ndonjëherë, duke rezultuar i pakuptueshëm. Është e nevojshme të sillet në latinishten klasike, (që gjer më sot nuk është sjellë) ku prej aty rezultojnë dallime të dukshme veçanërisht për morfologjinë dhe fonetikën: (po aty) ky lajm është sjellë shumë bukur nga prof. FAHRI Xharra në librin e tij “Roma fliste Shqip” dhe është materiali i dytë mbi të cilën ai mbështetet se mbishkrimi nuk është në latinisht por është në gjuhën shqipe. Nuk duam të marrim përsipër shkrime historike që deri tani nuk i ka marrë askush përsiper t’i përkthejë por do japim mendimin tone modest jo për të konkuruar me ndonjë mendim a person por në ndihmë të shkencës e historisë. Që në vitin 1889 kur është gjetur rreth këtij guri ka pasur shumë polemika. I pari që referoj në menyre zyrtare është Giuseppe Gatti (.ACME – Annali della Facolta di Lettere e Filosofia dell’università degli studi di Milano, Volume LVIII Settembre –dicembre 2005) i cili duke përgatitur shkrimin për (Notizie degli scavi di antichità) kufizon përshkrimin e vendit të gjetur duke thënë që mbase prezanton një vend religjioz i hapur i goditur nga rrufetë dhe që legjenda popullore e kujton si varrin e Romolo (Themeluesi i Romës) (G.Gatti, Nuove scoperte nella città di suburbio, Notie degli Scavi di antichità, 12, 1898 pp. 491-492) .

Pa dashur të sjellim polemikat që janë bërë rreth këtij guri në shekuj këtu kërkojmë pa sforcime të shqipërojmë gurin e gjetur në Romë. Sigurisht kush e lexon këtë gur tani nuk duhet te imagjinojë e lexojë në shqipen e sotme për të cilën janë bërë shumë kongrese drejtshkrimi për t’a sjellë në gjëndjen që është sot, duhet të imagjinojmë një gjuhë që ka përdorur zanoret por që i ka vendosur siç ka dashur vetë (edhe sot në gegënishte ndodh kjo) dhe për këtë më shumë do mbështetemi tek dialekti gegë i folur sot në pjesë qendrore e veriore të trojeve të vjetra shqiptare. Mos të presim fjali të plota sepse guri është dhe i dëmtuar dhe duhet të jenë fshirë shumë nga shkronjat, plus gjuha e vjetër është shumë arkaike edhe për shqipen, por shumë nga fjalët e Lapis Giner shqipërohen shumë thjeshtë dhe kjo na bën krenarë sepse edhe pse e quajmë grego - etruske nuk kane arritur t’a përkthejnë vetëm kanë përdorur legjendën popullore që aty eshte varrosur Romolo themeluesi i Romës. Karakteristikë e këtij shkrimi është që shkruhet herë nga e djathta dhe herë nga e majta. Në disa nga rreshtat shprehjet janë të ndara dhe me dy

pikështa. Nuk duam të marrim lavdinë mbi mundin dhe sakrificën e shumë studiuesve që janë përpjekur t'a përkthejnë gurin por të lajmerojmë të gjithë këta studiues se nëse do kërkonin ndihmë nga gjuha shqipe besoj se do gjejnë përgjigjen që se kanë marrë me shekuj, jo nga gjuha greke, por nga gjuha shqipe e cila flitet edhe sot mbase po me ate stil mënyrë që flitej edhe mijëra vjet më parë. Me anë të këtij guri ne kujtojmë dhe fjalë të vjetrat tona që i kemi në përdorimin e përditshëm por harrojmë sa të vjetra janë dhe që në gjuhën shqipe kanë përfaqësuar më shumë se një objekt ose përcjellin një ose më shumë kuptime.



Fjalët e shkruara sillen nga “Latinisht” shqip – italisht-shqip në tabelat e mëposhtëme.

Latinisht	Shqip	Italisht	Shqip sot
Quoi		Quis	Këtu
Hoi	Hoje-bletesh		Varrezë
Sakros		Sacros	Shenjtë
es	esht	è	Eshtë
Ed	Ed	Ed	Eduard
Sorm	Sorm		Serm

Ia	Ja	ecco	Ja
ias	jasht	fuori	Jashtë
re		re	Mbret
gei	gjej	trovo	Gjej
ic	Hic , hik	Niente, se ne andato	Hiç , ka ik

E vam	E shkum , erdhem	Siamo andati , venuti	Shkuam, erdhëm
quos		Dove	Ktu, ku
Ri,	I ri, rri	Giovane, sta	I ri, rri

mkal	Ne kal	Al cavallo	Në Kal
Ato	ata	Loro	Ata
ram	ran	caduti	ranë
Oi Od Oi	Oi Odoard Oi	O Odoard O	Oj Odoard Oj
Ux	Uh		Uh
men		uomeni	Burra
Ta kapia	Ta kapia	Se lo prenderò	Nëse do ta zë
Do ta v	Do ta vras	Lo uccido	Do t'a vras
mi	Me	Con	Me

Te	Ty	Te	Ty
Ria	Rrija	Restavo	Rrija
Mku oi	Ma ku ai	Dova sta lui	Ku është ai
Ha			
Vel Od	Vella Od	Fratello Od	Vëlla Odoardo
Ne-qu	Ne -ktu	Noi qua	Ne këtu
odio		Odio	Urrejtje
vest	More vesht	Hai saputo	Ke dëgjuar
Od			

KËTU ËSHTË VARREZA E SHËNJTË E ODOARDOS SERM/JA JASHTË MBRETI KA IK NUK GJENDET/NE ERDHËM KTU KU AI RRI/N'KALË TË RANË OJ OD OJ/UH BURRA NËSE DO TA KAP DO TA VRAS ME TY RRIJA, PO KU ËSHTË AI/VELLA ODOARD NE KËTU VETËM URREJTJE

Shohim fjalën Hoj. Në fjalorin “ Treçani” “Lapis Niger” thuhet se ka formën e një trapezi. Hoje në shqip janë trapezët e bashkëngjitur ku merret mjalti i bletëve, por dhe një varrezë ku bletet vdesin. I lidhur me bletët në përjetësi njeriu i ka trajtuar këto insekte inteligjente me një respekt të veçantë përderisa në gjuhën shqipe akoma sot bletës i thuhet vdes sikurse i thuhet njeriut. Pra fjala Hoj – Hoje tek Guri tregon një varrezë dhe fjala që vjen pas është Sakr pra e shenjtë. Do të thotë se ajo varrezë ka diçka të veçantë dikush aty i shenjtë është varrosur. Një fjalë tjetër e përkthyer është dhe fjala SORM (për këtë falenderoj prof. Pjetër Markun) në shqip mund t’ a shqipërojmë edhe Serm, metal me vlerë që është përdorur për të bërë objekte me vlerë por mbase është përdorur edhe si epitete ashtu sikurse në përdorim sot: djalë flori, vajzë- flori. Me copëzat e shkruara duke kërkuar t’ju jepet kuptim, thuhet se aty janë varrezat por Mbreti aty nuk është “JA JASHTË MBRETI KA IK ose ka iç (NUK GJENDET)” që do të thotë se aty ska njeri të varrosur. Sipas shkrimeve të vjetra thuhet se varreza u prish për shkak të “Galli Senoni” gjatë shkatërrimit rreth 390 vjet para Krishtit. Ata që kanë shkruar atë Gur sigurisht duhet t’ a kenë shkruar pas profanacionit të varrezave duke kujtuar se ata erdhën në kuaj dhe e prishën ato Hoje të shenjta ku pushonte Mbreti. Edhe sipas studiuesëve të tjerë Lapis Niger dhe Vazoja Duenos jane bërë në të njëjtën kohë. Edhe tek Lapis Niger dhe tek Vazoja gjejmë fjalët Ed o Od. Në latinisht ata janë dy emra Eduard e Odoard, Odoard i përdorur shumë shpesh per emra fisnikësh në Itali , ndërsa Eduard është një emër i vjetër shumë përhapur dhe në trojet shqiptare.

Do ishte kënaqësi që të ballafaqojmë studimet rreth këtij Guri me argumenta jo me mllafe se këtu askush nuk do të marrë primatin, por t’i bëjmë shërbim historisë e kulturës shqiptare dhe gjuhës së vjetër shqipe mbi bazën e së ciles u krijua latinishtja, jo përse këtë dëshirojmë ne por, se për këtë flasim faktet. Tani ishte pjekur koha që letërsia latine të sfidonte letërsinë greke, e cila atëherë konsiderohej e patejkalueshme. Në brezin tjetër, nën principatën e Augustit, lulëzuan poetët më të mëdhenj të Romës; Latinishtja Perandorake dhe Latine e Vonë u bënë të rëndësishme si gjuhë zyrtare e Perandorisë Romake, e përdorur si lingua franca veçanërisht në pjesën perëndimore të saj. Në Lindje, kjo idiomë solli ndryshime të dukshme midis shekujve të parë dhe të katërt në gadishullin Ballkanik (në Daçia, i rindërtuar si provincë në gjysmën e dytë të shekullit të tretë në jug të Danubit, në Moesia, madje edhe në Maqedoninë Veriore, ku ata do të lindin në të pestin shekull dy perandorë bizantine të gjuhës amtare latine) dhe në disa zona të Azisë (përfshirë Berytus, selia e një prej shkollave më prestigjioze të ligjit në botën romake, Heliopolis dhe gjashtë kolonitë italice të Pisidia). Sidoqoftë, ai nuk arriti të minonte komunën διάλεκτος koinë diàlektos si gjuhë e kulturës dhe përdorimit në Mesdheun lindor, madje as në Konstandinopojë, një qytet në të cilin latinishtja, mjaft e përhapur sidomos midis klasave të larta deri në rreth 450, po tërhiqej gjithnjë e më parë përpara tek Greqishtja e cila u bë, në dekadën e tretë të shekullit VII, gjuha zyrtare e Perandorisë Romake Lindore, ose Perandorisë Bizantine, e cila do të zgjasë deri në 1453.

Latinishtja Mesjetare dhe Humaniste, me rënien e Perandorisë Romake, Latinishtja përdorej ende për shekuj si e vetmja gjuhë e shkruar në botë që kishte qenë romake. Në kancelaritë e mbretërve, në curia romake, në liturgjinë e kishës katolike, në prodhimin e librave e vetmja gjuhë ishte latinishtja; por ishte një latin gjithnjë e më i ndikuar nga gjuha e folur. Në fakt, në një periudhë shumë të vështirë për t’u vendosur midis Perandorisë së vonë dhe Mesjetës së hershme, Latinishtja Vulgare kishte filluar të diferencohet duke i dhënë fillimin Proto-Romancës dhe më pas fazave të hershme të gjuhëve aktuale Romane (përfshirë Italishten).

Gjuha e Skënderbeut



Ky gur është një gur i vjetër i tempullit të Afërditës (Venerës). Mbi tempullin e lashtë të Afërditës italian dhe shqiptarë bashkë ndërtuan një Santuar në fshatin Venerë, provinca e L'Aquilës ku ndodhet Santuari i dytë pas asaj të Gjenacanos në Itali i Zojës së Shkodrës i bërë nga princërit Kolona 80 vjet pas vdekjes së Skënderbeut.



Në gurin e vjetër është gdhendur një antifonë e ungillit, por rreshtin e fundit asnjë arkeolog nuk arrin t'a deshifrojë. Ata mendojnë se ai rresht është shkruar nga një analfabet. Por nuk është e mundur që të lejohej një analfabet të shkruante mbi murin e një kishe. Ky gur është shkruar nga ndonjë nip i Gjergj Albanezit i cili së bashku me de sclavis shoqëruan Zojën e Shkodrës në Genacano në Itali.

Këtu shkruhet: **NEI MURAD ESTE FAN FALA RNESTA**

NË KTO MURE ËSHTË THANË FALJA E NDERSHME (VËRTETË)

Në kto rreshta gjejmë **N** të vjetër, **D** në vend të **T**, **R** shkronjë e vjetër, **A** e vjetër.

PËRFUNDIME

Duke parë që këto gurë flasin shqip do të ishte mirë të krijohej një grup pune për përkthimin e shumë shkrimeve të tjera etruske. Të punohej pse jo dhe me sardët, se pse mbas 2300 vjetësh morën guximin e të thonin nuk është latinisht Vazo e Duenos, edhe ne mund të ngremë zërin të themi se kto pllaka flasin shqip. Të gjitha mbishkrimet kanë elementë etrusko Pellazg dhe prandaj janë të lidhur me njëri-tjetrin pavarësisht ku janë gjetur.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. Francesco Della Corte, *Avviamento allo studio delle lettere latine*, Genova 1972 (varie edizioni, fin dall'ed. Torino 1952)
2. Germano Proverbio, *Lingue classiche alla prova: note storiche e teoriche per una didattica*, Bologna, Pitagora, 1981
3. Germano Proverbio, *La didattica del latino: prospettive, modelli ed indicazioni metodologiche per lo studio e l'insegnamento della lingua e della cultura latina*, Foggia, Atlantica, 1987
4. Lao Paoletti, *Corso di lingua latina. I. Fonetica, Morfologia, Sintassi*, Paravia, Torino, 1974, 16^a rist. 1987 pp. 604. ISBN 8839503870 ·
5. Italo Lana (a cura di), *Il latino nella scuola secondaria*, La Scuola, Brescia, 1990
6. Alfonso Traina, Giorgio Bernardi Perini, *Propedeutica al latino universitario*, 6^a edizione riveduta e aggiornata a cura di Claudio Marangoni, Bologna, Pàtron, 1998
7. Moreno Morani, *Introduzione alla linguistica latina, Lincom Europa*, 2000
8. Alfonso Traina, *L'alfabeto e la pronunzia del latino*, 5^a ed., Bologna, Pàtron, 2002 [1957], ISBN 88-555-2637-5.
9. Alfonso Traina, Tullio Bertotti, *Sintassi normativa della lingua latina*, Bologna, Cappelli, 2003 (1^a ed. 1965-1973)
10. Maria-Pace Pieri, *La didattica del latino*, Roma, Carocci, 2005
11. Lorenzo Ieva, **Il latino come lingua dell'Europa unita. Studio sul regime linguistico dell'U. E.**, Napoli, Editoriale scientifica, 2009
12. Nicola Flocchini, Piera Guidotti Bacci, Marco Moscio, *Nuovo Comprendere e tradurre*, Milano, Bompiani, 2001
13. Gaetano De Sanctis - *Il lapis niger e la iscrizione arcaica del foro romano* - Rivista di filologia e di istruzione classica - 28 - 1900 - - Claude Moatti - *Roma antica* - ed. Electa/Gallimard, - 1992 - - Giacomo Boni - *Scavi al Foro Romano: esplorazione del comizio*. - Roma - Accademia dei lincei - 1900 -
14. Guido Di Nardo - *Monumenti arcaici del Palatino* - Ed. Ruiz - Roma - 1954 -
15. Guido Di Nardo - *La Roma preistorica sul Palatino, il primato italico sulla civiltà mediterranea* - Albano Laziale
16. Francisco Villar, *Indo-Evropianët dhe origjina e Evropës*, f. 483